

## PROCEDURA PËR VËRTETIM IDENTITETI OSE SAKTËSIM EMRI

### **Përshkrimi i Shërbimit (skeda e Shërbimit)**

<u>Emri i Shërbimit</u>	<b>Kërkesë për vërtetim identiteti ose saktësim emri</b>
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	<p>Ky shërbim mundëson saktësimin e emrit. Qytetari duhet të jete vetë prezent. Në rast se babai figuron i vdekur nuk mund të lëshohet vërtetim. Në këtë rast personi duhet të drejtohet në Gjykatë. Gjithashtu dhe në rast se është bërë gabim datëlindja.</p> <p>Vërtetimi nuk mund të lëshohet në qoftë se personi ka ndërruar emrin ose mbiemrin në shtetin grek, pavarësisht se mund të jetë i pajisur me dokument zyrtar nga ai shtet .</p>
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Ligji Nr. 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”</li><li>▪ Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”</li><li>▪ Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”</li><li>▪ Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile"</li></ul>
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Njësitë Administrative dhe Rajoni Administrativ
<u>Afati</u>	Brenda <b>ditës</b>
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Dokumentin zyrtar të identitetit që ka sot (pasaportë ose kartë identiteti).</li><li>▪ Dokumentin në të cilin është bërë gabim; emri, mbiemri ,atësia.</li><li>▪ Certifikatën personale nga gjendja civile në të cilën duhet të cilësohet emri ose mbiemri që është ndërruar me vendim të Këshillit të Bashkisë.</li></ul>
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit . (outputs)</u>	Vërtetim për saktësimin e emrit
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Njësinë Administrative Sportelet në Rajonet Administrative